



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilaški Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council

Në mbështetje të nenit 110 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Nr. 03/L-244);

Duke pasur parasysh standardet e njohura ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të cilat specifikisht i garantojnë secilit individ barazinë parimore para ligjit, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për dëgjim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur e krijuar me ligj;

Duke u bazuar në Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara për Pavarësinë e Pushtetit Gjyqësor, të aprovuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në nëntor 1985 si dhe në udhëzimet mbi rolin e prokurorëve të adoptuar nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e të Pandehurve;

Duke u bazuar në Rekomandimin Nr. R (19) 00 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës drejtuar shteteve anëtare mbi rolin e prokurorit publik në sistemin penal të drejtësisë;

Duke pranuar që prokurori i shtetit luan një rol themelor dhe mbanë përgjegjësi të rëndësishme në administrimin e drejtësisë. Në emër të shoqërisë dhe interesit publik, ata janë në veçanti përgjegjës për të siguruar zbatimin e ligjit në rastet kur shkelja e ligjit sjell për pasojë sanksione penale, duke pasur parasysh në çdo rast të drejtat e individëve dhe efikasitetin e nevojshëm të sistemit penal të drejtësisë;

Duke pasur parasysh që sjellja e duhur etike dhe perceptimit i sjelljes së duhur etike, janë esenciale në kryerjen e të gjitha aktiviteteve të një anëtari të sistemit prokurorial;

Duke ditur që në pajtim me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, prokurorëve u garantohet liria e shprehjes, besimit, mbledhjes dhe organizimit si çdo çdo qytetari tjetër, megjithatë, gjatë ushtrimit të këtyre të drejtave, prokurori duhet gjithmonë të sillet në atë mënyrë që të mbrojë dinjitetin e zyrës së tij/saj, si dhe paanësinë dhe pavarësinë e institucionit prokurorial; dhe

Duke pasur parasysh që parimi i ndarjes së pushtetit respektohet në lidhje me detyrat e prokurorit dhe aktivitetet jashtë fushës së lëmit penal, dhe që të sigurohet roli i gjykatës në mbrojtjen e të drejtave të njeriut;

Të vetëdijshëm për nevojën, për të adoptuar dispozita që synojnë të mbështesin efikasitetin, paanshmërinë dhe drejtësinë e prokurorëve të shtetit, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), miraton:

KODIN E ETIKËS DHE SJELLJES PROFESIONALE PËR PROKURORË

Neni 1 Qëllimi

Ky Kod përkufizon standardet vijuese të etikës dhe sjelljes profesionale që duhet të zbatohen nga prokurorët. Shkelja e këtij/saj Kodi krijon baza për sanksione siç është parashikuar për dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe vlen për të gjithë prokurorët e shtetit, të të gjitha nivele të organizimit të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.

Neni 2 Parimet e përgjithshme

1. Format specifike të sjelljes së pahijshme të përshkruara në këtë Kod nuk janë gjithëpërfshirëse. Çdo sjellje e pahijshme apo veprim i ndërmarrë nga prokurori, edhe nëse nuk parashihet shprehimisht nga dispozitat e këtij Kodi apo në kodet, ligjet ose në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, por që ka efekt të ngjashëm konsiderohen shkelje e këtij Kodi dhe për rrjedhojë sanksionohen.
2. Gjatë gjithë kohës, prokurori do të veprojë në atë mënyrë që të nxisë besimin e publikut në dinjitetin, integritetin, efektivitetin dhe paanshmërinë e prokurorit.
3. Prokurori:
 - a) Respekton standarde të larta të sjelljes profesionale dhe personale;
 - b) Respekton dhe i përmbahet ligjit;
 - c) Kryen detyrat me paanshmëri dhe kujdes;
 - d) Shmang çdo sjellje apo situatë që mund të vërë në pikëpyetje integritetin apo paanshmërinë e prokurorit; dhe
 - e) Kryen detyrat e tij/saj/saj konform standardeve të njohura ndërkombëtarisht të drejtave të njeriut.
4. Kjo vlenë jo vetëm për jetën profesionale të prokurorit, por edhe për jetën e tij/saj

private, kur veprimet e prokurorit mund të dëmtojnë imazhin e prokurorit në sytë e publikut, duke ndikuar kështu në të gjithë institucionin e sistemit prokurorial.

5. Prokurori nuk përfshihet në asnjë veprimtari që është e papajtueshme me funksionet e tij/saj, përfshirë këtu edhe veprimtaritë politike.
6. Prokurori nuk mund të ushtrojë detyrë në asnjë partië politike apo të jetë anëtar i saj.
7. Detyrë e prokurorit është të kërkojë të vërtetën që përfshin marrjen parasysh të të gjitha provave, qofshin ato në favor apo jo të të pandehurit. Të gjithë prokurorët duhet t'i kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre me mirëbesim dhe të duhet të respektojë prezumimin e pafajësisë në çdo kohë.

Neni 3 RREGULLAT SPECIFIKE TË ETIKËS Veprimtaritë Prokuroriale

1. Prokurori ruan dhe përmirëson standardet më të larta të profesionalizmit dhe ekspertizës ligjore dhe për këtë qëllim, angazhohet në arsimimin dhe trajnime të vazhdueshme ligjore kur është e mundshme.
2. Në veçanti, prokurori respekton dhe zbaton:
 - a) Parimet dhe detyrat etike të detyrës sikurse përcaktohen në këtë Kod të sjelljes;
 - b) Mbrojtjen ligjore të të dyshuarve, viktimave dhe dëshmitarëve;
 - c) Të drejtat dhe liritë e njeriut sikurse përcaktohen nga instrumentet ndërkombëtare;
 - d) Parimet dhe praktikën e organizimit të punës, menaxhimit dhe burimeve njerëzore në kontekst prokurorial dhe gjyqësor.
3. Prokurori duhet të ketë dijeni dhe të përfitojë njohuri për:
 - a) kornizën ligjore, mekanizmat dhe resurset e disponueshme për kryerjen e funksionit të tij/saj; dhe,
 - b) llojet dhe zhvillimet e kriminalitetit, si dhe kërkesat dhe modalitetet e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështje penale.
4. Prokurori ka në veçanti përgjegjësinë të shmangë çdo konflikt të mundshëm interesi të bazuar mbi marrëdhëniet shoqërore apo familjare si dhe mbi marrëdhëniet financiare apo profesionale, në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit.
5. Për çdo rast, nëse prokurori vihet në dijeni të ndonjë konflikti interesi tjetër apo se ka rrethana që mund të ngrenë dyshime lidhur me paanshmërinë e tij/saj, ai/ajo duhet t'i ndërpresë të gjitha veprimet në atë rast dhe menjëherë këto rrethana i raporton me shkrim mbikëqyrësit të prokurorisë. Në rast se mbikëqyrësi i

prokurorisë konstaton se në rastin e caktuar nuk ekziston konflikti i interesit, me shkrim e njofton prokurorin për mundësinë e vazhdimit të veprimtarisë së tij/saj.

6. Në çdo rast, nëse prokurori, e fshehtë, respektivisht nuk e raporton ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit apo çfarëdo rrethane tjetër që mund të ngrisë dyshime në lidhje me paanësinë e tij/saj, por ndonjëri nga kolegët e tij prokuror ka njohuri për këtë rrethanë, do të ishte e detyrueshme për këtë prokuror që këtë rrethanë t'ia raportojë Kryeprokurorit.
7. Raporti në mes të prokurorit dhe mbikëqyrësit të tij:
 - a) Prokurori kryen detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj pa ndërhyrje të pajustificueshme;
 - b) Prokurori duhet të lejohet që të kryej detyrat dhe përgjegjësitë pa ekspozim të pajustificueshëm ndaj përgjegjësisë civile, penale apo tjetër;
 - c) Prokurori respekton udhëzimet ligjore që janë dhënë nga autoritete hierarkike;
 - d) Prokurori gëzon të drejtën të kërkojë që udhëzimet të cilat i drejtohen të jenë me shkrim;
 - e) Prokurori duhet të jap llogari periodikisht për veprimtaritë e tij/saj në tërësi dhe në veçanti mbi mënyrën se si i ka ushtruar përgjegjësitë e tij/saj.
8. Në raport me gjyqtarët, prokurori i shtetit:
 - a) Respekton pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve; nuk hedh dyshim mbi vendimet gjyqësore dhe as nuk pengon në ekzekutimin e tyre, me përjashtim të rasteve kur ushtrojnë të drejtat e tyre për ankesë ose thirren në ndonjë tjetër procedurë në përputhje me ligjin;
 - b) Është objektiv dhe i/e drejtë gjatë procedurës gjyqësore;
 - c) Nuk kritikon gjyqtarët publikisht në mënyrë të papërshtatshme.
9. Në raport me policinë, dhe autoritet e tjera:
 - a) Në rastet kur ligji i zbatueshëm percakton që prokurori të udhëheqë procedurën penale paraprake apo lejon që t'iu kërkojë agjencive që zbatojnë ligjin të ndërmarrin veprime specifike, jap udhëzime të ligjshme, të qarta sipas nevojës me qëllim që të arrihet ndjekje penale efikase;
 - b) Nxitë raportimin dhe sanksionimin, sipas nevojës për veprimtaritë penale; dhe
 - c) Në çdo rast nxitë bashkëpunimin e duhur dhe funksional me policinë dhe agjenci të ndryshme të zbatimit të ligjit.
10. Në raport me avokatët mbrojtës, prokurori:
 - a) gjithmonë vepron me integritet; dhe
 - b) nuk përfshihet në sjellje të papërshtatshme apo të padrejtë.

11. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre ndaj individëve, prokurori:

- a) zbaton funksionet e tij/saj ne menyre te drejte, paanshme dhe objektive.
- b) respekton dhe kerkon mbrojtjen e të drejtave te njeriut;
- c) kërkon të sigurohet që sistemi i drejtësisë penale vepron me sa me efikasitet dhe shpejtësi që është e mundur. Kjo nënkupton që prokurorët nuk angazhohen në asnjë formë abstenimi, mos-efikasiteti dhe neglizhence në punë dhe sigurohet që arrihet bashkërendimi i duhur me agjencitë e zbatimit të ligjit, sic parashihet me ligjin e aplikueshem, duke marr parasysh edhe mundesine per marreveshje te pranimit te fajesise, diskrecionit, ndermjetesimit apo instituteve tjera;
- d) shmanget nga diskriminimi mbi çfarëdo baze duke shmangur çdo sjellje diskriminuese ndaj çdonjërit person apo persona mbi çfarëdo baze, përfshirë gjininë, moshën, statusin martesor, gjuhën, paaftësinë mendore apo fizike, orientimin seksual, përkatësinë apo bindjen politike, origjinën etnike, kombësinë, fenë apo besimin, racën, origjinën shoqërore, statusin pronësor, të lindjes apo çdo status tjetër;
- e) siguron barazi para ligjit, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante përfshirë ato që ndikojnë tek i dyshuari, pavarësisht nëse janë në favor apo disfavor të të dyshuarit.

12. Prokurori:

- a) Nuk fillon apo vazhdon ndjekjen penale kur është i detyruar të mos veprojë ashtu sipas ligjit, apo kur ka baze ligjore te parapare me ligj;
- b) Nuk paraqet prova të pavlefshme që mund të ndikojnë në vlefshmërinë e vetë procedurës;
- c) Kërkon të ruajë parimin e barazisë së palëve, në veçanti duke iu treguar palëve të tjera, me përjashtim të rasteve kur ligji e parasheh ndryshe, çdo informacion që ata kanë që mund të ndikojë në nje procedure te drejte;
- d) Ruan informacionin e fshehtë të përfutur nga palët e treta, veçanërisht kur prezumimi i pafajësisë është në rrezik, nëse bërja e ditur e këtij/saj informacioni është në interes të drejtësisë apo të ligjit;
- e) Ka konsideratë për interesat e dëshmitarëve, në veçanti merr apo nxit masa që mbrojnë jetën, sigurinë dhe privatësinë e tyre, ose përkujdeset që këto masa të ndërmerren;
- f) Ka konsideratë për pikëpamjet dhe shqetësimet e viktimave kur preken interesat e tyre personale;
- g) Nuk lejon që ndikimet e papërshtatshme të pengojnë përndjekjen e zyrtarëve publik për vepra të kryera nga ta, veçanërisht korrupsion, përdorim të paligjshëm të pushtetit, shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe vepra të tjera penale të njohura nga e drejta ndërkombëtare;
- h) Ai/ajo dhe as familjarët e tij/saj, në asnjë rrethanë nuk do të pranojnë dhurata, favore, privilegje apo premtime për ndihmë materiale nga ndonjë person që ka interes të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë në lëndën për të cilën ata janë përgjegjës;

- i) Në varësi të dispozitës së nenit 6 b) më lart, është i lirë t'i dorëzojë gjykatës çdo argument ligjor që ata zgjedhin, edhe nëse kanë për detyrë t'i pasqyrojnë me shkrim udhëzimet e pranuar.

12. Prokurori mbanë komunikim të hapur dhe aktiv me publikun dhe mediet.

Neni 4 Veprimtaritë joprokuroriale:

1. Në parim prokurori mund të kryejë lirisht veprimtari jashtë lëmisë së mandatit prokurorial, duke përfshirë ato veprimtari që janë mishërimi i të drejtave të tij/saj si qytetar apo që përfaqësojnë interesat dhe pavarësinë e tij/saj profesionale.
2. Si përjashtim nga paragrafi 1, prokurori nuk mund të kryej veprimtari që janë të papërputhshme me reputacionin e institucionit, apo negativisht ndikon besimin profesional dhe publik në sistemin prosekutorial.
3. Në veçanti, prokurori nuk:
 - a) angazhohet në asnjë veprimtari, përfshirë veprimtari politike, që është e papërputhshme me funksionet e prokurorit;
 - b) ka post apo është anëtar i ndonjë partie politike; ose,
 - c) angazhohet në veprimtari joprokuroriale gjatë orarit të punës pa miratimin e paraparak nga Këshilli Prokurorial i Kosovës. Koha dhe kushtet e angazhimit përcaktohen nga Këshilli.
4. Prokurorit i ndalohet të shfrytëzojë pozitën e tij/saj lidhur me informacionet që i siguron përmes pozitës së tij/saj, qoftë për përfitim personal, apo për përfitimin personal të dikujt tjetër.
5. Prokurori nuk kërkon fonde për vete, për ndonjë organizatë apo agjenci, nuk lejon që emri i tij/i saj të përdoret për të kërkuar fonde dhe nuk lejon që të përdoret autoriteti i institucionit për atë qëllim.
6. Prokurori nuk mund t'i përket organizatave që mbështesin apo nxisin diskriminimin apo çdo lloj veprimtarie që nuk përputhet me funksionet e prokurorit.
7. Prokurori i shmanget marrëdhënieve financiare dhe të biznesit që mund të pasqyrojnë negativisht në paanshmërinë e tij/saj, ndërhyjnë në kryerjen e dudur të detyrave prokuroriale.
8. Çdo vit prokurori duhet t'ia paraqesë Agjencisë Kosovare Anti-Korrupsion pasurinë e tij në pajtim me ligjin.

Neni 5
Përgjegjësitë administrative

1. Prokurori ushtron përgjegjësitë e tij/saj/saj administrative me profesionalizëm dhe me kujdes, bashkëpunon me agjencitë e zbatimit të ligjit, gjyqtarët dhe zyrtarët tjerë të gjykatave gjatë administrimit të veprimtarive të prokurorisë.
2. Në veçanti, prokurori:
 - a) Respekton detyrimet e nevojshme që i përkasin funksionit të tij/saj/saj sa i përket mbikëqyrjes së stafit nën kontrollin apo mbikëqyrjen e tij/saj/saj;
 - b) Organizon veprimtarinë e tij/saj/saj dhe respekton detyrimet e posaçme të kohës dhe detyrës që janë të nevojshme për kryerjen e veprimtarive të tilla;
 - c) U përmbahet udhëzimeve administrative nga Këshilli Prokurorial i Kosovës në atë masë që udhëzimet e tilla synojnë racionalizimin dhe përmirësimin e udhëheqjes së vazhdueshme të veprimeve të prokurorive dhe nëse kjo nuk ndërhyt në vendosjen e lirë të prokurorit në ndonjë rast të caktuar.
3. Lidhur me organizimin dhe veprimtarinë e brendshme të prokurorisë, në veçanti ndarjen dhe rindarjen e lëndëve, prokurori shmang çdo ndikim të panevojshëm dhe maksimalizon funksionimin e duhur të sistemit të drejtësisë penale, në veçanti duke pasur parasysh nivelin e kualifikimit dhe specializimit që duhet t'i kushtohet secilës lëndë.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 6
Koordinimi me kodet tjera të mirësjelljes.

1. Në rastin e kundërthënies në mes të dispozitave të këtij kodi dhe dispozitave të kodit të mirësjelljes profesionale për anëtarë të Këshillit prokurorial të Kosovës, mbizotërojnë dispozitat e këtij kodi.
2. Ky Kod mund të ndryshohet dhe plotësohet me Vendim të KPK-së.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Miratuar me datë 31 korrik 2012



Ismet Kabashi
Ismet Kabashi
Kryetar Këshill Prokurorial të Kosovës